



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I DËGJIMIT PUBLIK NË KOMISIONIN PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
I MBAJTUR MË 29 MAJ 2019**

**SA JAVNE RASPRAVE KOMISIJE ZA EKONOMSKI RAZVOJ,
ODRŽANE 29. MAJA 2019. GODINE**

**MAJ - MAJ
2019**

Dëgjimin publik e drejton kryetarja e Komisionit, znj. Sala Berisha-Shala.

KRYETARJA: Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar pjesëmarrës, media, shoqëri civile të gjithë që jeni këtu,

I nderuar zoti Bakija, nga D+ si mbështetës i këtij projekti për monitorimin e këtij ligji të rëndësishëm.

E nderuara Gonxhe, Lume, gjithë ju të tjerë që jeni këtu,

Pra nuk po humbim kohë, sot ju kemi thirrur në dëgjimin publik që ka të bëjë me Ligjin për shërbime.

Është një ligj jashtëzakonisht i rëndësishëm, ka qenë si kërkesë e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit që edhe Kosova ta ketë një ligj të tillë.

Ne në kuadër të punëve tona si deputetë kemi obligim që dy ligjet në vit së paku t'i monitorojmë se sa po zbatohen me pa se ligjet të cilat i nxjerr Kuvendi i Kosovës a po zbatohen, nëse nuk zbatohet as nuk ka gatishmëri me u zbatua apo janë të pazbatueshme dhe në këtë mënyrë monitorojmë, shohim, detektojmë, vlerësojmë se ku duhet të ndryshohen dhe plotësohen ato ligje.

Unë do të dëshiroj që në fillim një ekspozitë të shkurtër në lidhje me monitorimin e ligjit edhe pse jemi përcaktua për këtë ligj.

T'ia kaloj fjalën Jetmir Bakisë, si përfaqësues i D+, të cilin edhe një herë po e falënderoj që na ka mbështetë gjatë gjithi kohës me monitorua këtë ligj.

Urdhëro zoti Bakija, fjala është për ju!

JETMIR BAKIJA: Faleminderit, kryetare!

Jetmir Bakija, prej Demokraci+, shkurt një kopje hulumtimi bazë dhe një grafikë pak që e shpjegon dispozitën ndoshta më kryesore të këtij ligji, pikën e vetme të kontaktit, besoj që secili e ka përpara.

Qëllimi i këtij ligji ndoshta pse edhe ne kemi pasur interes dhe kemi bashkëpunua me komisionin me monitorua për shkak se lëvizja e shërbimeve është një prej lirive themelore të Bashkimit Evropian, një prej katër lirive themelore përpos lëvizjes së njerëzve, kapitalit, mallrave pra edhe shërbimeve. Edhe në fakt ka dal prej një direktive të BE-së në vitin 2006, këtë ligj e ka çdo vend i anëtarit të BE-ë dhe Kosova si aspirante për Bashkimin Evropian ka marrë obligim që ta bëjë këtë. Tashmë është edhe në MSA në kapitullin II, përmendet Lëvizja e shërbimeve që e rregullon ky ligj.

Pra, është një ligj tejet i rëndësishëm për afarizmin, duhet me e sqarua ndoshta se edhe në vizitat kur kemi pasur ka pasur ngatërresa se për çfarë shërbime po flitet edhe pse titulli pak është ngatërrues apo shumë i përgjysmuar vetëm për shërbimet.

Këtu flitet për shërbimet e afariste, jo për shërbime për qytetarë, apo diçka tjetër dhe ka për qëllim që ta lentoj - shërbimet për ofruesit dhe vetë përfituesi.

Në hulumtim të cilin e kemi bë shumë të shkurt në shkurt para fillimit të monitorimit nga grupi punues nxjerrën edhe obligimet kryesore që dalin prej këtij ligji bartëse që është Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, besoj që do të tregojnë ndoshta ku është me monitorim, por është identifikimi i shërbimeve pra që rregullohen me këtë ligj se është një pjesë e madhe e shërbimeve që përjashtohen.

Këtu në grafik thuhet që 223 shërbime ekonomike apo afariste rregullohen me këtë ligj, ndërsa janë 46 shërbime që janë identifikua që në fakt rregullohen për shkak se rregullohen me ligje tjera të BE-së por edhe në Kosovë.

E dyta, është themelimi i pikës së vetme të kontaktit që në fakt është një porta elektronik ku i ofron të gjitha licenca dhe të gjitha procedurat për ofruesit vendor po në të ardhmen edhe të jashtëm që donë me ofrua shërbime në Kosovë, prapë po0 them shërbime afariste....

Dhe nën tre, funksionalizimi i këtij portalit elektronik edhe ofrimi i këtyre shërbimeve online, me qenë si është edhe brenda BE-së ku një biznes që ofron shërbime prej një shteti mundet me aplikua edhe me i pa të gjitha procedurat për shërbimet në një shtet tjetër pa pasur nevojë me shkua në zyre të shtetit të dytë.

Ky është pak qëllimi si ka nisur dhe çka përmban, nuk po e zgjati më shumë. Kaq!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Bakija!

Jua kaloj fjalën juve pjesëmarrës,

Ne deputetët nuk kemi nevojë shumë me fol nëse veç e kemi ndonjë paqartësi, sepse qëllimi i dëgjimit publik është me i dëgjua palët tjera të cilat nuk kanë pasur mundësi me marrë pjesë gjatë fazës së draftimit ose gjatë fazës së amendamentit në Kuvend.

Do t'jua kaloj fjalën juve pa humbur kohë. Dëshiroj që të prezantoheni cilido që e merrni fjalën.

Dhe krejt në fund për mos me u përsërit çka do që sot mund të na ofroni këtu kërkujmë që edhe me shkrim t'i dërgoni të gjitha vërejtjet, sugjerimet e juaja apo propozoi te Administrata që e mbështet Komisionin. Nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, zoti Blaca!

REXHEP BLLACA: Faleminderit!

Jam Rexhep Bllaca drejtor i Departamentit ligjor. Ne si Ministri e Tregtisë dhe Industrisë kemi qenë sponsorizuese e ligjit për shërbime.

Në vitin 2016 kemi ftuar me këtë ligj, dhe siç e përmendi zoti Bakija ky ligj transponon direktivën e shërbimeve për tregun e brendshëm të vitit 2006 .

Ne gjatë hartimit të këtij ligji po ashtu kemi marrë model Ligjin e Shqipërisë, Lituanisë dhe të Kroacisë.

Ne me miratimin e këtij ligji i cili ka për qëllim që ta përmirësoj ambientin e biznesit dhe t'i thjeshtëzoj të gjitha kriteret, procedurat me rastin e themelimit ose regjistrimit të një biznesi që ofron shërbime në Republikën e Kosovës duke reduktuar në minimum, maksimum të gjitha kërkesat, kriteret, gjithmonë duke pasur parasysh tekstin e proporcionalitetit dhe të legjitimitetit publik, domethënë që ne këtë kriter, një procedurë kërkesë mund të arsyetohet vetëm nëse është në interes publik, të sigurisë publike, në mbrojtje të konsumatorit, ambientit ose ndonjë interes tjetër publik. Me miratimin e këtij ligji ne edhe kemi marrë veprime për zbatimin e tij, në vitin 2017 është miratuar udhëzimi administrativ për procedurën e njoftimit dhe vlerësimit të përputhjes së drafteve, akteve normative me Ligjin për shërbime. Siç e përmendi zoti Bakija ne gjatë hartimit të këtij ligji kemi identifikuar 223 shërbime që mbulohen me këtë ligj, mirëpo është shumë me rëndësi të theksohet se kjo listë është indikativë nuk është përfundimtare. Gjithmonë mund të... shërbime të reja mirëpo edhe mund të shuhet shërbime, të cilat mund të mbulohen me këtë Ligj për shërbime, përkatësisht... për shërbime, por mund të rregullohen me ndonjë ligj specifik.

Po ashtu, gjatë vitit 2018 është miratuar edhe Udhëzimi Administrativ për themelimin e pikës së vetme të kontaktit dhe ne si Ministri e Tregtisë dhe Industrisë jemi duke hartuar edhe planin e veprimit për funksionalizimin e pikës së vetme të kontaktit. Ky plan për momentin është në konsultim publik dhe shpresojmë se së shpejti do ta procedojmë në qeveri për miratim. Ky pika e vetme të kontaktit ka për qëllim që nëpërmjet një portali të vetëm elektronik të ofrojë qasjen në informata qoftë të ofruesve të shërbimeve, po ashtu edhe përfituesve të shërbimeve.

Ne mendojmë këtë ta realizojmë në tri faza: faza e parë është pak më e thjeshtë, ku në këtë portal elektronik mendojmë me i vendosë vetëm ligjet, aktet nënligjore, procedurat administrative dhe kriteret, të cilat kërkohen me rastin e marrjes së ndonjë leje, licence, autorizimi, certifikimi e të tjera. Faza e dytë e pikës së vetme e kontaktit që është pak më e avancuar është përveç këtyre informatave ne mendojmë t'i paraqesim edhe formularët dhe modelet, aplikacionet në rastin e marrjes së ndonjë leje dhe licence. Ne në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për shembull në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve i kemi online, domethënë të gjitha formularët, statutet,

modelet me rastin e regjistrimit të një biznesi. Kështu që bizneseve u mbetet vetëm t'i plotësojnë këto të dhëna me të dhënat e veta të biznesit.

Po ashtu, është shumë me rëndësi që prej këtij viti kemi filluar edhe me regjistrimin online të bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, po ashtu edhe në mars të këtij viti ka hyrë në fuqi edhe Udhëzimi Administrativ për numrin unik identifikues, ku ky numër unik identifikues do të vlejë edhe për qëllimet tatimore doganore, kështu që bizneset më nuk kanë nevojë me u pajisë me 4-5 numra, por e marrin numrin unik identifikues në Ministrinë e Tregtisë, përkatësisht në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve dhe ai numër unik është si letërnjoftimi i personit, ai është si identitet për biznesin. Dhe faza e tretë e funksionalizimit të pikës së vetme të kontaktit që është edhe faza më e avancuar... kur të gjitha shërbimet ofrohen online, nuk ka kurrfarë kontakti fizik ndërmjet palëve dhe institucionit dhe qoftë leja, qoftë licenca përveç regjistrimit të gjitha ofrohen online.

Unë këtu pra e përfundoj që t'u jap hapësirë edhe të tjerëve, mirëpo megjithatë jemi të hapur për komente, sugjerime dhe njëherësh falënderoj Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik që e ka zgjedh këtë Ligj për shërbime e që është një ligj shumë i rëndësishëm pasi targeton një ndër katër liritë themelore të shërbimeve në tregun e Bashkimit Evropian, së bashku me lirinë e lëvizjes së mallrave, personave dhe kapitalit dhe ky përveç që është i rëndësishëm për përmirësimin e ambientit të biznesit në Republikën e Kosovës, po ashtu edhe e shpejton rrugëtimin tonë drejt Bashkimit Evropian. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Bllaca! Kush e donë fjalën? Ministria e Administratës Publike, zoti Balaj, fjala është e juaja.

BURIM BALAJ: Përshëndetje për të gjithë!

Jam Burim Balaj, nga Ministria e Administratës Publike. Me u ndërlidh në atë që tha i nderuari Rexhë kisha vazhduar te pika e vetme e kontaktit meqenëse kjo është pika më problematike ndoshta në këtë ligj edhe pjesë ku në fakt kemi të bëjmë edhe ne si ministri përgjegjës për këtë çështje. Meqenëse kjo çështje ose kjo direktivë e Bashkimit Evropian është e..., ose e përfshirë pak a shumë, dhe me Ligjin e procedurës të përgjithshme administrative, ne kemi paraparë d.m.th. edhe pikën e vetme të kontaktit në këtë ligj, e cila faktikisht është më e gjerë ose shumë më e zgjeruar sesa ajo çka përfshihet në Ligjin për shërbimet, se ne pretendojmë me këtë që t'i përfshijmë të gjitha llojet e shërbimeve që ofrohen brenda vendit.

Prandaj, sa i përket pikës së vetme të kontaktit, ne jemi shtrirë në dy drejtime, ne që e ceku edhe Rexha, do të thotë në aspektin e digjitalizimi të shërbimeve, ose ofrimin e portalit, ose krijimin e portalit e-Kosova, i cili vetëm është në fazën e tenderimit, ku për tri vjetët e ardhshëm do të ketë një vlerë rreth 3 milion e gjysmë, dhe do të kemi do të thotë një portal që pretendojmë deri në fund të vitit, nëse procedurat e prokurimit shkojnë ashtu si duhet dhe shpresojmë që do të jetë i

gatshëm veç të fillojë të ofrojë shërbime online për qytetarët, bizneset dhe të gjitha kategoritë e tjera.

Këtë çështje e kemi diskutuar disa herë edhe me vetë ministrinë, edhe në takimet që kemi pasur me ju si Komision, kemi diskutuar që të kemi një mundësi që t'i fuzionojmë, që mos të kemi duplikim të procesit. Andaj unë po e ritheksoj ose po e përsëris atë që e kemi diskutuar edhe në disa takime të tjera më herët, që pika e vetme e kontaktit, ajo e cila është paraparë edhe me atë planin që na e kanë dorëzuar Ministria e Tregtisë këto ditëve të fundit, të rishikohet mundësia, meqenëse ajo është paraparë në vitin 2022, të shikohet mundësia që të fuzionohet ose të jetë në kuadër të portalit E-Kosova, ku do të ketë të gjitha kompetencat prapë se prapë janë të Ministrisë së Tregtisë, sepse ne vetëm e ofrojmë infrastrukturën dhe të gjitha ato që janë të nevojshme për realizimin sa më të mirë të këtyre shërbimeve. Sepse kjo gjë është e ndërlidhur shumë edhe me platformën e interprobalitetit, të cilën ne veç e kemi legalizuar dhe jemi duke i ndërlidhur sistemet e ndryshme elektronike që i kanë institucionet, databazat e ndryshme pa të cilat është e pamundur që të ofrohen shërbimet deri te qytetari, pra në dorën e fundit, një shërbim elektronik i plotë.

Për këtë arsye, mendoj që duhet të rishikohet ky plan dhe të parashihet mundësia që të përfshihet në portalin E-Kosova, ku do të jetë pjesë e veçantë, patjetër do të jetë modul i veçantë, ku do të përfshihen të gjitha përgjegjësitë të cilat rrjedhin nga ky ligj. Në të njëjtën kohë do t'i jap përgjegjësi prapë se prapë Ministrisë së Tregtisë.

KRYETARJA: Faleminderit! Me sa po kuptoj unë, po ju shoh edhe dy përfaqësuesve, njëri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe një i Ministrisë së Administratës Publike, që jeni në këtë drejtim duke punuar diçka, se ka për të mbetur kjo pika e vetme. Është me rëndësi që kjo çështje të rregullohet dhe të jetë sa më efektive, dhe ku mbetet a te portali E-Kosova a mbetet te Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ndoshta kjo pak e ka rëndësinë. Rëndësinë e ka që të funksionalizohet dhe shërbimet, sidomos ato që janë jashtë vendit të kenë një adresë, një qasje sa më lehtë. Kështu që, besoj që edhe ne derisa ta finalizojmë krejt raportin e këtij monitorimi të ligjit ndoshta do të kemi edhe diçka konkrete nga ana e Qeverisë, përkatësisht dy ministrive përfaqësuese që i kemi këtu.

Faleminderit z. Balaj. Kush e do fjalën dikush tjetër? Urdhëro! Prezantohu të lutem, fjala është e juaj.

RREZARTA AJETI: Faleminderit!

Unë jam Rrezarta prej ARKEP-it, Rregullatori për Komunikime Elektronike. Faleminderit së pari që na keni ftuar. Unë e kam lexuar ligjin veç si titull më përpara, po kam supozuar që jemi të përjashtuar prej këtij ligji. E pashë që ne nuk jemi pjesë e këtij ligji, për shkak se e kemi ligjin e

veçantë. Po e shoh që po mungojnë shërbimet postare, po i kam kontrolluar direktivën, edhe në direktivën që jam bazuar, shërbimet postare janë përjashtuar dhe ne kemi në ligj të veçantë.

Çështja që u ngrit këtu, që edhe mua më preokupon është portali që do të bëhet për informata të cilat duhet ofruar për ata jashtë vendit që janë të interesuar. Ne para dy vitesh e kemi dorëzuar informata në Zyrën e Kryeministrit. Të gjitha autorizimet, se ne tash lëshojmë vetëm autorizime, se e kemi liberalizuar tregun, nuk ka më licenca. Të njëjtat informata i kemi dorëzuar edhe në MTI.

Tash pika e vetme e kontaktit e cila do të jetë, për shkak se ne kur ka ndryshime, tash ka pasur ndryshime në Ligjin për shërbimet postare, ne e kemi njoftuar Zyrën e Kryeministrit, për shkak se tash kur ka hyrë në fuqi në dhjetor ligji, edhe aty janë hequr licencat, tash ka autorizime. Tash vetëm pasi u hap ky debat, ndoshta kishte qenë mirë që kjo të sqarohet që ne ta dimë kë ta informojmë për ndryshimet që i kemi në legjislacion edhe procedurat të cilat i thjeshtësojnë për të marrë leje te na. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Edhe njëherë po e përsëris; çdo vërejtje, sugjerim, duke përfshirë edhe këtë pyetje tuaj të fundit, i përcillni me shkrim te administrata e komisionit. Ne i shqyrtojmë pastaj si grup punues edhe si komision.

E do dikush tjetër fjalën? Ju nga Oda Ekonomike...

LUMNIJE HASHANI: Përsëritje për të gjithë! Unë jam Lumnije Hashani, zyrtare ligjore në Odën Ekonomike të Kosovës.

Sa i përket këtij ligji, ne kemi bashkëpunuar me biznese dhe kemi menduar që t'i marrim propozimet e tyre se sa është i zbatueshëm në praktikë, por kemi hasur në disfavore të tyre, duke thënë që, deri më tani edhe pse ka hyrë në 2016-ën në fuqi, nuk kanë pasur benefite të duhura.

Pra, duke e cekur se ky ligj bie në kolizion me 25 ligje të tjera, dhe momenti i disa neneve të cilat e kanë paraparë që 5 vite pas nënshkrimit të hyjë në fuqi, atëherë edhe ajo paraqet pengesë ose barrierë për ta për sa i përket të të bërit biznes.

Nëse ne i shikojmë bizneset dhe afarizmin e tyre të cilët janë të ndarë në lëmenj të ndryshëm, atëherë e shohim se disa janë disa shërbime të inkuorporuara, ndërsa disa shërbime përjashtohen.

Nëse nisemi si portal ose si pasqyrë, ku Oda Ekonomike ofron të dhëna për të gjitha bizneset të cilat bëjnë biznes edhe jashtë, po edhe brenda Kosovës, dhe kanë potencial të japin ndihmë sidomos për bizneset e jashtme të cilat kur vijnë në Kosovë kërkojnë ndihmë rreth infrastrukturës, ambientit të të bërit biznes, si dhe heqjen e barrierave të tjera.

Pra, ne mendojmë që në këtë ligj të përfshihet edhe si pikë në atë portalin, i cili është paraparë si pikë fokale ose pikë e vetme të ketë qasje edhe Oda Ekonomike, në mënyrë që në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë të bëhet edhe një pasqyrë, meqë jemi duke punuar në platformën e digjitalizimit të të dhënave të të gjitha bizneseve.

Sigurisht se, të gjithë ata që kërkojnë ndihmë nga ne, pra fjala është për bizneset, atëherë Oda Ekonomike të jetë një pikë ku do të informohen të gjitha bizneset të cilat kërkojnë akses, ose ndihmë ose mbështetje për zhvillimin e biznesit të tyre.

Ne e kemi dëshmuar këtë me Ministrinë e Tregtisë, ku në shumë aspekte Oda Ekonomike ka marrë shumë ingerenca. Po ashtu edhe Ligji mbi Odën Ekonomike, kur Kuvendi i Kosovës i ka dhënë autorizime publike siç janë: lëshimi i barkodeve dhe certifikata mbi origjinën e mallit dhe dihet se këto janë autorizime publike ose shërbime të cilat i përdorin bizneset, ose iu ndihmojnë bizneseve.

Ne mendojmë që, meqë shumë vende të tjera, ndoshta edhe Kroacia ose vende të tjera e kanë si pikë fokale Odën Ekonomike, konsiderojmë që së pari duhet të plotësim-ndryshimi i këtij ligji. T'i japim komentet bazë të bizneseve, dhe pastaj ta shohim se në cilin vend mund të inkorporohet edhe Oda Ekonomike. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Po, ne ishim në Kroaci dhe e pamë atje, pika e vetme e kontaktit ishte te Oda Ekonomike, po nuk domethënë që ndonjë shtet...Shqipëria nuk e di ku e ka, e as Lituania, të cilën Qeveria e ka marrë si model për hartimin e këtij ligji.

Mirëpo, kjo nuk do të thotë që ne t'i kopjojmë ashtu pikë për pikë, sepse unë mendoj që aty ku ka gatishmëri me të vërtetë për të punuar, ku ka infrastrukturë e të tjera, aty duhet të mbetet, sepse pika e vetme e kontaktit është një pikë jashtëzakonisht e rëndësishme.

Tash, po e them këtu se Oda e Ekonomike, me gjithë respektin, por, nuk e di jam shumë skeptike. Ne kemi kërkuar dy-tre herë takim dhe udhëheqësit e Odës Ekonomike nuk kanë gjetur kohë që të na presin.

Tash, nuk e di se sa do të jenë të gatshëm t'i përgjigjen kësaj kërkesë ligjore, dhe të shohim ne si deputetë. Në fund ne do të vendosim, t'i shohim, t'i analizojmë.

E thashë edhe me parë se qëllimi është të funksionalizohet pika e vetme e kontaktit, dhe besoj se të gjitha institucionet do të kontribuojnë në këtë drejtim. Pra, kudo që të jetë pika e vetme e kontaktit do të kontribuojnë me informacione të cilat janë të nevojshme për shërbimet që janë të interesuara të vijnë dhe të kryejnë shërbime në Kosovë.

A e dëshiron fjalën dikush tjetër? Urdhëro, zoti Balaj!

BURIM BALAJ: Nëse po e konsiderojmë si të mbyllur këtë pjesën e pikës së vetme të kontaktit, një çështje tjetër të kisha dashur ta ngriti është pikërisht harmonizimi i ligjeve tjera ose ligjeve të reja me Ligjin për Shërbimet, por jo vetëm me këtë, po edhe me ligjet e tjera, siç është Ligji për Procedura Administrative.

Kemi diskutuar edhe në takimin e fundit që e kemi pasur bashkë, ku edhe në këtë pikë nuk e kemi ndoshta një bashkëpunim të mirë mes institucioneve. E kam fjalën për ministrinë përgjegjëse në këtë rast.

Në të njëjtën kohë, unë po e shoh që po mungojnë nga Zyra e Kryeministrit. S'po e di a është dikush prej tyre, po aty është një komision i cili është themeluar. Ndoshta Rexha, veç është pjesë e atij grupi punues dhe nuk e di për barrierat administrative.

Andaj, mendoj se do duhej që të ngritet edhe kjo çështje, meqenëse është e pamundur që për disa ligje të ndryshme, në vazhdimësi të kërkohet një opinion ose një harmonizim, një përputhshmëri, sepse siç e dini edhe me Ligjin e Procedurës Administrative i kemi mbi 200 e disa ligje të cilat janë në kundërshtim dhe duhet të unifikohen me atë ligj.

Po ashtu, të njëjtën gjë e kemi edhe me Ligjin për Shërbime dhe me disa ligje të tjera të cilët i rregullojnë këto fusha, këto çështje.

Andaj, unë mendoj që është shumë me rëndësi që edhe në këtë pikë ta kemi një unifikim dhe ndoshta ai komisioni i cili është themeluar në kuadër të Zyrës së Kryeministrit ta kryejë punën për të gjitha.

Në momentin që një ligj dërgohet që të shikohet se a është në harmoni me këto ligje, të shikohet njëherë për të gjitha dhe jo të bëhet në mënyrë vetjake ose ndaras për... Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Besoj që është mirë që të vendoset ky komunikimi ndërinstytucional.

Ne i kishim përfaqësuesit e Zyrës së Kryeministrit dhe, në komision dhe ata ishin duke punuar në një program për zvogëlimin e barrierave administrative. Besoj që mes vete si institucione do të harmonizohen dhe do të dalin më në fund me një ide ose një propozim, ose me diçka që i funksionalizon shërbimet dhe jo vetëm shërbime, po edhe segmentet tjera që kanë të bëjnë me rregullimin e mënyrës së të bërit biznes në Kosovë, dhe të tjera.

E ka kërkuar fjalën zoti Bakija. Urdhëro!

JETMIR BAKIA: Po, ndoshta vetëm sa për t'ju kthyer paksa pikës së vetme, ngase konsideroj që është e rëndësishme.

Për shkak të thjeshtësimit të procedurave administrative për ofruesit e bizneseve, meqë ndoshta është pika e dytë më e rëndësishme e këtij ligji. Po, vetëm të PVK-ja, te pika e vetme e kontaktit; sfida e parë është themelimi, mirëpo sfidë edhe më e madhe është integrimi, funksionalizimi që nënkupton integrimin e të gjitha databazave të cilat ekzistojnë në Kosovë për biznese.

Pra, që i ka MAP-i, MTI-ja, ishin në Komunën e Prishtinës, nuk e di a është ndonjë përfaqësues këtu nga Komuna e Prishtinës.

Komuna e Prizrenit ka filluar me pikën e vetme komunale. Komuna e Prishtinës i ka disa databaza që na treguan...Ndoshta duhet të shikohet kjo sesi mund të zbatohet dhe të vihet në funksion kjo pikë e vetme e kontaktit, për shkak se aty është edhe sfida më e madhe meqë përshihen shumë shërbime siç u potencua.

KRYETARJA: Faleminderit!

Dikush tjetër e dëshiron fjalën? Dikush nga deputetët? Atëherë, nëse nuk e do fjalën askush, konsideroj që është shterur debati. Kërkojmë që t'i dërgoni me shkrim.

Edhe ashtu, sot deputetët janë duke pritur që të shkojnë në përrurimin e autostradës. Po e shohë që po iu duket çdo minutë vonesë.

Faleminderit shumë për pjesëmarrje! Mirupafshim në takimet tjera. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*